UDHËZIM
Nr. 3, datë 13.2.2024

PËR DISA NDRYSHIME DHE NJË SHTESË NË UDHËZIMIN NR. 14, DATË 27.5.2019, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR PËRGATITJEN DHE LËSHIMIN E KARTËS SË STUDENTIT"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 100, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, dhe të vendimit nr. 226, datë 17.4.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për kategoritë e shërbimeve, të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit",

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 14, datë 27.5.2019, "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për përgatitjen dhe lëshimin e kartës së studentit", bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) kudo në përmbajtjen e udhëzimit togfjalëshi "*Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë*", zëvendësohet me togfjalëshin "*ministria përgjegjëse për arsimin*";

b) Pika 3, riformulohet si më poshtë:

"3. Studenti mund të përfitojë kartën e studentit kur ai regjistrohet pranë një institucioni të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";

c) pas pikës 3, shtohet pika 3/1, me përmbajtjen si më poshtë:

"*3/1. Institucioni i arsimit të lartë brenda vitit akademik përcjell pranë institucionit përgjegjës për emetimin e kartave të studentit listën e studentëve të rinj të pajisur me numër identifikues matrikullimi (NIM) nga QSHA-ja";*

d) pika 7 e shkronjës "a", të shtojcës nr. 1 "Udhëzuesi teknik", zëvendësohet si më poshtë:

"7. Numri identifikues ID (NID);"

2. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Ogerta Manastirliu